



Duke u mbështetur në Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr.05/031 Nenin 153 dhe Nenin 154 si dhe duke u mbështetur në nenin 40.2 shkronja a) dhe l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040, Programin Nacional për Zhvillim Ekonomik, Lokal dhe Kornizën Afatmesme të shpenzimeve, Statutit të Komunës së Klinës Neni 40 paragrafi 2 pika I. Me shkresën nga MAPL të datës: 16.01.2024 me nr.020-1010/4, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e I-rë të rregullt për vitin 2024 të mbajtur me datën: 26.01.2024, mori këtë:

## V E N D I M

Për

*rishqyrtimin e Vendimit 01Nr.06-43402/2023 për miratimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik, Lokal për Komunën e Klinës 2024-2029*

1. Me anë të këtij Vendimi rishqyrtohet akti i miratuar me nr.01Nr.06-43402/2023 për miratimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik, Lokal për Komunën e Klinës 2024-2029.
2. Miratohet me plotësim-ndryshime Strategjia për Zhvillim Ekonomik, Lokal për Komunën e Klinës 2024-2029, duke e harmonizuar atë me Programin Nacional për Zhvillim Ekonomik, Lokal dhe Kornizën Afatmesme të shpenzimeve sipas kërkesës së MAPL-së.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Strategjia për Zhvillim Ekonomik, Lokal për Komunën e Klinës 2024-2029.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga kuvendi i komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

### Njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunes;
- Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim;
- Zyra për Informim;
- Arkivi.

### KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-3482 /2024  
Klinë, me 01.02 /2024



KRYESUESI,  
Fadil Gashi